



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Mirënjohje Mëdha			
28.04.2017			
Nr. i organit Org. nr. 01	Numri/broji	Shkronja P. 01	Vlera Vrednosit
02-013/1475			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008), nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NDARJEN E 130 BURSAVE
PËR STUDENT TË KOMUNËS SË VITISË

I

Neni 1 i Vendimit për ndarjen e 130 bursave për student të Komunës së Vitisë ndryshohet dhe bëhet:

Komuna e Vitisë NDAN 150 bursa për student të Komunës së Vitisë për vitin akademik 2016/2017. Vlera e bursës është 300,00€ (treqind euro) për këtë vit akademik. Bursat ndahen: për student të fakulteteve të lëmime deficitare, për student të familjeve përfituese të ndihmës sociale, për student të familjeve të dëshmorëve, për student të invalidëve të luftës, për student të veteranëve të luftës, për studentë pa prind në jetë si dhe për student dy prej një shtëpie.

II.

Komisioni për ndarjen e bursave, pas shqyrtimit të kërkesave për ndarjen e bursave ka konstatuar se ka pas një numër më të madh të kërkesave që i kanë plotësua kushtet dhe kriteret për ndarjen e bursës, dhe i kanë propozuar kryetarit që ta rrit numrin e bursave nga 130 në 150 bursa. Kryetari i Komunës e ka miratua këtë propozim dhe ka vendos që numri i bursave për vitin akademik 2016/2017 të jetë 150 bursa,

Mjetet buxhetore për 20 bursa shtesë sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga kodi buxhetor për subvencione i Zyrës së Kryetarit të Komunës së Vitisë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Drejtori i Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Vitisë.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Arsim
2. Drejtorisë për Financa
3. Arkivit

